



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

**MODALITET PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË PROGRAMIN E  
STUDIMIT DOKTORATË NË “SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE”, PËR  
VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Program i studimit të doktoratës në “Shkenca Mjekësore Teknike” përfshihet në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor në Shkenca Mjekësore Teknike”. Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegrit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.

Për të kryer regjistrimin në programin e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- të ketë përfunduar studimet e larta në shkencat mjekësore teknike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlerëshëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;
- të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, në momentin e aplikimit;
- të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët e që zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;
- të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;
- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- çertifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;
- dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar;
- dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, pjesëmarrje në konferenca shkencore apo eksperiencia akademike;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi. Projekt propozimi duhet të jetë në përputhje me projektin kërkimor zhvillimor “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, të aksesueshëm në : <https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike/njoftime> ;
- vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;
- mandat pagese për tarifën e aplikimit, mund të gjendet në: <https://uniel.edu.al/zona-e-sherbimeve> ;
- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**  
**KOLEGJI DOKTORAL**

**PROCEDURA E KONKURRIMIT**

Procedura e konkurrimit do të kalojë nëpër tri faza

• **FAZA 1 VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM**

Vlerësimi i kualifikimeve të bashkëngjitura në aplikim nga secili kandidat. Pikët maksimale janë 50 pikë, të ndarë si më poshtë:

- nota mesatare mbi 8 (10 pikë)
- Projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë)
- publikime të mëparshme (10 pikë)
- vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë)
- eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë)

*Aplikanti, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkëkruar, nëpërmjet postës, në adresën: Rruga "Bedri Xhoma" Elbasan, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, brenda datës 10.05.2022.*

**Brenda datës 13.05.2022 të ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, afishohet lista e studentëve fitues.**

• **FAZA 2 PROVIMI ME SHKRIM**

Pikët maksimale janë 25.

Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga Kolegji Doktorale. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurrimit.

Provimi me shkrim, do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë 16.05.2022, ora 10.00-12.00, salla 202 godina C (Telemedicina).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
KOLEGJI DOKTORAL**

- **FAZA 3 PROVIMI ME GOJË**

Pikët maksimale janë 25.

Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj.

Provimi me gojë do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë 18.05.2022, ora 10.00-14.00, salla 202 godina C (Telemedicina).

*Pas përfundimit të tri fazave, Kolegji Doktorale, shpall brenda datës 20.05.2022 listën e plotë të aplikantëve, të renditur dhe të kualifikuar 7 kandidatët që kanë marrë me shumë pikë. Aplikanti mund të njihet mbi vlerësimin e tij, nëpërmjet kërkesës drejtuar Kolegjit Doktorale, mbi vlerësimin e aplikimit të tij. Aplikanti merr përgjegjësi me shkrim, brenda 10 ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës.*